



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 24.9.2023

Nr: 785

Ora: 07:00

VENDIM

PËR

**PAJISJEN E QENDRËS SË POSAÇME TË VOTIMIT NR. 0636/01, KZAZ NR. 11, BASHKIA KUKËS,
ME SASINË SHITESË TË FLETËVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË
BASHKISË KUKËS TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2, nenit 93, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V Ë R E J:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 11, Bashkia Kukës, ndërmjet komunikimit zyrtar kërkon fletë votimit shtesë për I.E.V.P Kukës, dhe i ka propozuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pajisjen e kësaj I.E.V.P me sasinë shtesë të fletëve të votimit.

Shtetasit të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion kanë fituar të drejtën për të votuar në qendrën e posaçme të votimit nr. 0636/01, KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, sipas vendimit të gjykatës.

Në qendrën e posaçme të votimit nr. 0636/01, KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, do të votojë edhe administrata zgjedhore.

Në këto kushte, KQZ duhet të marrë masa të sigurojë sasi shtesë të fletëve të votimit për të mundësuar votimin e shtetasve të sipërcituar.

Data: 24.9.2023 Nr: 785
Ora: 07:00



“Për pajisjen e qendrës së posaçme të votimit nr. 0636/01, KZAZ nr. 11, Bashkia Kukës, me sasinë shtesë të fletëve të votimit, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023”

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 11, Bashkia Kukës, që të pajisë me sasinë shtesë të fletëve të votimit, qendrën e posaçme të votimit nr. 0636/01.
2. Sasia shtesë e fletëve të votimit do të merret nga qendra e votimit nr. 0636/00, e KZAZ nr. 11, përkatësisht 25 (njëzet e pesë) fletë votimi për kandidatët për kryetar bashkie.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI